

DITARI MUJOR

SHTATOR 2024

MINISTRJA PIRDENI NË FORUMIN STRATEGJIK TË BLEDIT, NË FOKUS INTEGRIMI I BP

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, ishte pjesë e delegacionit të drejtuar nga Kryeministri Edi Rama në Forumin Strategjik të Bledit 2024. Diskutimet e forumit "Një Botë me realitete paralele" u përqendruan në çështje kritike për rajonin, si siguria, të drejtat e njeriut dhe integrimi i Ballkanit Perëndimor në Bashkimin Evropian. Pjesëmarrësit theksuan nevojën e bashkëpunimit për të ndërtuar një të ardhme më të sigurt në një kohë kur bota përballet me konkurrencë, pasiguri dhe konflikte. Në panelet e organizuara, u diskutua roli i BE-së në përballimin e sfidave globale. Pjesëmarrësit nënvizuan nevojën për një politikë të jashtme më të unifikuar për të adresuar konfliktet dhe përmirësimin e marrëdhënieve ndërmjet BE-së dhe vendeve të Ballkanit Perëndimor



MBI 400 DREJTUES TË ADMINISTRATËS PUBLIKE, PJESË E PROGRAMIT TË ZHVILLIMI TË LIDERSHIPIT

Programi i Zhvillimit të LiderShipit, një nismë e re nga Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, në bashkëpunim me UNDP dhe Bashkëpunimin Austriak për Zhvillim, ka vijuar gjatë muajit shtator sesionet e trajnimit. Programi po trajnon intensivisht mbi 400 drejtues të mesëm dhe të lartë për të nxitur frymën e bashkëpunimit brenda ekipeve të administratës publike. Iniciativa ka për qëllim të përmirësojë kapacitetet drejtuese dhe menaxhuese të pjesëmarrësve duke u përqendruar në zhvillimin e një kulture të re organizative që favorizon bashkëpunimin dhe efikasitetin. Bashkëpunimi në ekip, fuqizimi i stafeve, frymëzimi për përfshirje dhe menaxhimi i vetes janë disa nga temat e trajtuara në program.



MINISTRJA PIRDENI VIZITON GJIMNAZIN "ASIM VOKSHI": DO ZGJEROJMË MODULIN ANTIKORRUPSION NË ARSIMIN PARAUNIVERSITAR

Ministrja Pirdeni vizitoi gjimnazin "Asim Vokshi" në Tiranë, një nga 12 shkollat ku po zbatohet programi "Edukimi mbi Korrupsionin". Kjo iniciativë synon ndërgjegjësimin e brezit të ri mbi vlerat e drejtësisë dhe integritetit. Gjatë takimit me nxënësit e klasave të 10-ta, ministrja theksoi rëndësinë e modelimit të sjelljeve antikorrupsion që në bankat e shkollës. "Në fillim, ky projekt nisi në katër shkolla të Tiranës dhe tashmë është shtrirë në 12 shkolla në mbarë vendin. Jemi krenarë që gjimnazi "Asim Vokshi" është një ndër gjimnazet që ka përqafuar këtë ide," - theksoi gjatë fjalës së saj Ministrja. Gjatë bashkëbisedimit me nxënësit dhe mësuesit, Ministrja Pirdeni priti sugjerime për përmirësimin e programit, duke theksuar se do të punohet për ta bërë modulin edhe më tërheqës



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN



Ministër i Shtetit për Administratën
Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni

DITARI MUJOR

SHTATOR 2024

KRIJOHET KOMITETI I PËRBASHKËT KONSULTATIV BE-SHQIPËRI

Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, ishte pjesë e delegacionit të drejtuar nga Kryeministri Edi Rama në Komisionin Evropian në Bruksel. Ministrja mori pjesë në takimin ku ishte i pranishëm Presidenti i Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian, Z. Oliver Ropke, ku u diskutua iniciativa e Komitetit Ekonomik dhe Social Evropian për të sjellë më afër shoqëritë civile nga të dyja palët, me qëllim përshpejtimin e mundësive që lidhen me procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Brukseli do të krijojë një Komitet të Përbashkët Konsultativ, i cili do të monitorojë dhe japë këshilla për anëtarësimin e Shqipërisë dhe vendeve candidate për BE.



MINISTRJA PIRDENI TAKIM NË KËSHILLIN E ÇËSHTJEVE TË PËRGJITHSHME TË BE-SË: SHTETI I SË DREJTËS, KRYEFJALA E DETYRIMEVE TONA DREJT FAMILJES EVROPIANE



Ministri i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin, Znj. Adea Pirdeni, mori pjesë në mbledhjen e Këshillit të Çështjeve të Përgjithshme të BE-së, zhvilluar në Bruksel. Fokusi kryesor i takimit ishte situata e shtetit të së drejtës në vendet e Bashimit Evropian dhe në vendet candidate për anëtarësim në BE. Në fjalën e mbajtur, ministrja riafirmoi angazhimin e palëkundur të Shqipërisë për të çuar përpara punën për forcimin e shtetit të së drejtës. "Në këtë drejtim konsolidimi i një gjyqësori të reformuar, të mbështetur mbi parimet e integritetit dhe profesionalizmit, si dhe përforcimi i masave ligjore dhe hetimeve administrative në luftën kundër korrupsionit, janë prioritet absolute të qeverisë shqiptare," theksoi ministrja. Mes përpjekjeve për të forcuar më tej sundimin e ligjit dhe mirëqeverisjen, ministrja Pirdeni përmendi krijimin e Komisionit të Posaçëm Antikorrupsionin.

FORCIMI I BASHKËPUNIMIT ME INSTITUCIONET SHQIPTARE: PËRFAQËSUESI RAJONAL I ZYRËS SË UNODC VIZITON MAPA-N

Përfaqësuesi rajonal i Zyrës së OKB-së për Drogat dhe Krimin (UNODC) për Evropën Juglindore, Z. Danilo Rizzi zhvilloi një takim me përfaqësues të Ministrisë së Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin. Zoti Rizzi u prezantua me të gjitha iniciativat e ndërmarra nga MAPA dhe qeveria shqiptare në luftën kundër korrupsionit dhe rritjen e standardit të integritetit në institucionet publike. Në qendër të diskutimit ishin dhe fushat konkrete me të cilat MAPA mund të bashkëpunojë me UNODC në vijim.



REPUBLIKA E SHQIPËRISE
MINISTËR SHTETI PËR
ADMINISTRATËN PUBLIKE
DHE ANTIKORRUPSIONIN



Ministër i Shtetit për Administratën Publike dhe Antikorrupsionin
Adea Pirdeni



mapa.gov.al
adeapirdeni



APirdeni